

KONTRATË SHIT-BLERJE

Aksione të shoqërisë “THERMO+SWISS” sh.a.

Sot më 21/12/ 2017, ne palët e mëposhtme me vullnetin e tonë të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, redaktuam këtë kontratë:

SHITËSI: **DASHAMIR DOÇI**, biri i Rakip-it, i datëlindjes 13.03.1973, madhor, me zotësi juridike e zotësi të plotë për të vepruar, banues në Elbasan, mbajtës i Leternjoftimit me Nr. Personal H30313020G,

DHE

BLERËSI: **“DAST (Delta Adhesive Structural Tech)” Sh.A.**, me NIPT K81401501G, me zyrë qendrore në adresën: Autostrada Tiranë – Durrës, Godina Dast, Km.30, përfaqësuar nga Z.LUAN MUÇA, biri i Shahin-it, i datëlindjes 05.08.1971, madhor, me zotësi juridike e zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë, Njësia bashkiake nr. 2, Rr. “Elbasanit”, mbajtës I Leternjoftimit me Nr. Personal H10805062A;

TË DHËNA PARAPRAKE:


- Shitësi, Dashamir Doçi, është zotërues i 50 % (pesëdhjetë përqind) të aksioneve të shoqërisë “THERMO + SWISS” SH.A, me NIPT L51423049P, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare, me zyra Qendrore në adresën: Fshati Ahmetaq, Rruja Nacionale Vorë-Fushë Krujë.
- Asambleja e ortakeve të shoqërisë “THERMO + SWISS” SH.A, me NIPT L51423049P, me vendim Asambleje, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Statutin e Shoqërisë, ka vendosur:
Te miratohet shitja e 25 % të aksioneve të zotëruara nga aksionari i kësaj shoqërie Z. Dashamir Doçi në favor të “DAST (Delta Adhesive Structural Tech)” Sh.A., me NIPT K81401501G;
- Asambleja e ortakeve të shoqërisë “DAST (Delta Adhesive Structural Tech)” Sh.A., me NIPT K81401501G, me vendim Asambleje, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Statutin e Shoqërisë, ka vendosur:
Te miratohet blerja e 25 % të aksioneve të zotëruara nga aksionari Z. Dashamir Doçi, dhe të përfaqësohenet në këtë blerje nga Administratori i saj Z. Luan Muça.

NENI 1 – Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë së luajtshme, 25 (njëzetë e pesë) aksioneve, te cilat përfaqësojnë 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë “THERMO + SWISS” SH.A, me NIPT L51423049P, nga shitësi në favor të blerësit.

NENI 2 – Çmimi

- 2.1. Shitësi ia shet këtë pasuri blerësit kundrejt një çmimi prej 218'750 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lekë ; që përbën vlerën përkatëse të tyre në kapitalin e likujduar ;
- 2.2. Çmimi është paguar i plotë në para fizike (CASH), nga blerësi në favor të shitësit dhe deklarojmë se nuk ka asnjë pretendim.



NENI 3 – Të drejta dhe detyrime të palëve

- 3.1. Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mbajnë përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar;
- 3.2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate me të gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ana e këtij të fundit;
- 3.3. Shitësi duhet t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate blerësit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve;
- 3.4. Blerësi ka detyrim të njoftojë brenda pesë ditëve shitësin në rast se të tretë, ngrënë pretendime pronësie mbi pasurinë objekt kontrate.

NENI 4 – Kalimi i pronësisë

- 4.1. Me nënshkrimin e kontratës, shitësi zhvishet plotësisht nga pronësia mbi 25% të aksioneve - objekt kontrate dhe ajo i kalon e plotë blerësit.
- 4.2. Me nënshkrimin e kontratës, blerësi bëhet bashkëaksionar i "THERMO + SWISS" SH.A, me NIPT L51423049P, në zotërim të barabartë aksionesh (prej 25% secili) me tre aksionarët e tjera: Dashamir Doçi; Bledar Kabashi dhe Oltion Kabashi.

NENI 5 – Të ndryshme

- 5.1. Palët do të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 5.2. Palët do të përpilen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata redaktohet në gjuhën shqipe në tre kopje origjinale, me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

Datë: _____

SHITËSI

DASHAMIR DOÇI

DASHAMIR DOÇI

[Handwritten signature]

BLERËSI

"DAST (Delta Adhesive Structural Tech)" Sh.A.,
Përfaqësuar nga :

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]